

KLSH merr pjesë në Takimin Vjetor të EUROSAT, Grupet e Punës mbi Auditimin Mjedisor (EUROSAT WGEA – EUROSAT Working Group on Environmental Auditing), me titull “SUSTAINABLE ENERGY”, organizuar nga Zyra Supreme e Auditimit, Poloni (SAO of Poland), EUROSAT WGEA dhe Zyra Supreme e Auditimit, Çeki (SAO of Czech Republic), në data 24 – 26 Shtator, 2023, në Pragë, Çeki.

Qëllimi kryesor i këtij organizimi ishte “*Energjia e qëndrueshme – Sustainable energy*”. Prezantimet, diskutimet dhe puna në grup u fokusuan në tema të tilla si efienca e energjisë, mbështetja për burimet e rinovueshme të energjisë, tregjet dhe siguria e energjisë, subvencionet e energjisë, siguria energjetike, pavarësia energjetike, kursimi i energjisë, etj. Këto tema konsiderohen me rëndësi të lartë në vitet e fundit në Evropë dhe gjithashtu në lidhje me zhvillimet e ardhshme. Në takim, u diskutuan gjithashtu shembuj të ndryshëm të vendeve pjesëmarrëse mbi masat e marra në fushën e qëndrueshmërisë së energjisë, si dhe qasjen e audituesve ndaj këtyre masave dhe njohuri të reja në kuadër të projekteve të auditimit të lidhura me energjinë. Në takim morrën pjesë 72 auditues nga 29 shtete të ndryshme të Evropës. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), u përfaqësua nga katër auditues, z. Paolo Xhezo, znj. Olisa Foto, z. Erand Rroboçi dhe z. Bush Bushaj.

Zyra Supreme e Auditimit, Çeki, në rolin e organizatorit të këtij takimi vjetor, së bashku me përfaqësuesit e EUROSAT WGEA dhe përfaqësuesit e Zyrës Supreme të Auditimit, Poloni, drejtuan takimin me temë “*Energjia e qëndrueshme – Sustainable energy*”. Në takim u diskutua mbi përparimin në drejtim të objektivave të klimës dhe energjisë, në nivel kombëtar dhe për BE, mbi energjinë e qëndrueshme, në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, mbi rezultatet paraprake të auditimeve në temën e prodhimit të energjisë elektrike (siguria e furnizimit dhe burimet e rinovueshme), mbi auditimet për dekarbonizimin e sektorit të energjisë dhe matësve inteligjentë, mbi efencën e energjisë në ndërtesa private dhe publike, risqet dhe barrierat e politikave të energjisë së rinovueshme, vlerësimi i veprimeve të qeverisë për të arritur reduktimin e dëshiruar të emetimeve të gazrave të dëmshëm, etj.



Gjithashtu, të ftuarit u organizuan në katër grupe pune me tema “Mjetet e politikave fiskale të gjelbra”; “Efienca energjetike”; “Energjia e rinovueshme”; “Siguria e energjisë”. Përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit morrën pjesë në grupin e punës me temë “Efienca energjetike”, ku u diskutua mbi risqet, sfidat, metodat që institucionet e auditimit mund dhe duhet të përdorin me qëllim rritjen e parametrave të efencës së energjisë.

Pse duhet të implementohen auditimet mbi efencën e energjisë?

Auditimet e energjisë ofrojnë përmirësime dhe zgjidhje në fushën e rritjes së parametrave të efikasitetit të energjisë, të tilla si zbulimi dhe korrigjimi i humbjeve dhe përdorimit pa efikasitet të energjisë, optimizimi i performancës dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe rritja e qëndrueshmërisë mjedisore. Këto auditime promovojnë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e energjisë, si dhe të kursejnë dhe të përmirësojnë financat. Duke kryer auditime të rregullta të energjisë, operatorët e këtij sektori mund të fitojnë njohuri të reja për modelet e tyre të përdorimit të energjisë, të krahasojnë performancën e tyre me standardet më të mira evropiane dhe t'i japin përparësi masave për përdorimin me efikasitet të të ardhurave.

Sfidat e auditimeve të efikasitetit energjitike.

Pavarësisht përfitimeve të auditimeve të energjisë, shumë operatorë gjejnë vështirësi për të zbatuar rekomandimet nga raportet e auditimit. Sfidat e zakonshme kanë të bëjnë me buxhetin dhe burimet e kufizuara, mungesën e aftësive dhe njohurive teknike, barrierat organizative dhe barrierat rregullatore të tregut. Për shembull, projektet e efikasitetit të energjisë shpesh kërkojnë investim kapital paraprak që mund të mos jetë i disponueshëm ose i justifikuar nga periudha e pritshme e kthimit të investimit; ato mund të përfshijnë aspekte teknike komplekse që kërkojnë ekspertizë dhe trajnim të specializuar; mund të përballen me rezistencë ose indiferencë nga instancat më të larta, stafi ose palët e interesuara që nuk janë të vetëdijshëm për përfitimet, stimujt ose praktikatat më të mira të efikasitetit të energjisë. Projektet e efikasitetit të energjisë mund të pengohen nga faktorë rregullatorë ose të tregut, si çmimet e ulëta të energjisë, kostot e larta të investimit ose mungesa e standardeve ose politikave që mbështesin efikasitetin e energjisë.

Strategji për të kapërcyer sfidat për zbatimin e rekomandimeve.

Për të kapërcyer sfidat dhe barrierat për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të energjisë, operatorët mund të kërkojnë financim të jashtëm, të ndërtojnë kompetenca të brendshme, të nxisin kulturën dhe angazhimin organizativ dhe të shfrytëzojnë mundësitë e tregut. Operatorët e këtij sektori mund të investojnë gjithashtu në zhvillimin e aftësive teknike dhe njohurive të stafit, kontraktorëve ose konsulentëve të tyre. Për më tepër, ata mund të angazhohen me instancat më të larta, stafin dhe palët e interesuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të krijuar mbështetje për përfitimet e efikasitetit të energjisë.

Përgjatë trajnimit, audituesit e KLSH-së prezantuan për kolegët e huaj metodologjinë dhe proceset e punës që institucioni ndjek në lidhje me auditimin e efikasitetit të energjisë. Ky trajnim vlerësohet si tepër i vlefshëm për audituesit e KLSH-së, pasi informacioni dhe eksperiencia e marrë nga katër audituesit pjesëmarrës në organizim do t'ju kalohet dhe audituesve të tjerë të KLSH-së. Ky trajnim dhe të tjerët në vijim që janë parashikuar të zhvillohen në të ardhmen në kuadër të bashkëpunimeve të institucionit me institucione të tjera homologe, konsiderohen si një hap i rëndësishëm dhe cilësorë në realizimin dhe përmbushjen e objektivave dhe misionit të KLSH-së.

